



UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE FILOLOGJISË  
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

**PROGRAMI I LËNDËS**  
**Drejtimi: Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore**

**TITULLI I LËNDËS: GREQISHTE E VJETËR**

**Pedagogu:** Dr. Arta Sula  
**Ngarkesa:** 4 ECTS (30 leksione dhe 15 seminare)  
**Lloji i lëndës:** lëndë me zgjedhje  
**Programi i studimit:** bachelor  
**Viti/Semestri:** II/II

#### **EKSTRAKT**

Studimi i gramatikës së gjuhës së vjetër greke kërkon relativisht një kohë të gjatë. Nisur nga fakti se është lëndë semestrale, objektivi ynë është të ofrojmë njohuritë dhe mjetet e nevojshme që studenti të ketë mundësinë, jo vetëm të kuptojë terma të ndryshëm dhe prejardhjen e termave të caktuar, por edhe të jetë në gjendje të kuptojë një tekst me ndihmën e një fjalori. Njohuritë do të jenë kryesisht në fushën e morfologjisë, por pa lënë mënjanë disa elemente sintaksore të rëndësishme.

Për çdo leksion do të pregatiten skeda të caktuara gramatikore.

Një hapësirë e vogël do t'i kushtohet edhe qytetërimit grek.

#### **TEMAT:**

**LEKSION 1.** Shkrimi dhe fonetika. Alfabeti, theksi dhe frymët.

**LEKSION 2.** Fenomenet fonetike.

**LEKSION 3.** Rregullat mbi theksin.

**LEKSION 4.** Emri. Tema, numri, rasa, lakimet.

**LEKSION 5.** Lakimi i parë. Karakteristikat e emrave sipas gjinive.

**LEKSION 6.** Lakimi i dytë.

**LEKSION 7.** Lakimi i mbiemrave në – o / -a. Mbiemrat μέγας dhe πολύς.

**LEKSION 8.** Lakimi i tretë. Karakteristikat sipas mbaresës. Temat në bashkëtingëllore. Temat në dentale. Temat në –ντ. Temat në –λ, ρ. etj.

**LEKSION 9.** Temat në sibilante, në zanore dhe në diftong.

**LEKSION 10.** Lakime të veçanta.

**LEKSION 11.** Ndajfoljet. Mbiemri dhe shkallët e krahasimit.

**LEKSION 12.** Përemrat vetorë, vetvetorë, dëftorë.

**LEKSION 13.** Përemrat lidhorë, pyetës, të papërcaktuar.

**LEKSION 14.** Numërorët.

**LEKSION 15.** Folja, tema, mbaresat. Zgjedhimi dhe format e pazgjedhueshme.

## **FORMA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT**

### **FREKUENTIMI:**

70% pranisë në seminare e domosdoshme.

*15 % e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve*

### **KONTROLLI I VAZHDUESHËM:**

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (20% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (20% e notës përfundimtare)

*40 % e notës përfundimtare.*

### **KONTROLLI PËRFUNDIMTAR:**

Një test përfundimtar në javën e 16-të të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri

*45% e notës përfundimtare*

## **DETYRIMET E STUDENTËVE PËR LËNDËN**

Frekuentim i rregullt në leksione.

Frekuentim i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times New Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesëmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi (provimi) përfundimtar (i fundit të semestrit)

**LITERATURA:**

1. *Gramatikë e gjuhës së vjetër greke.* A. Lukinovich, M. Rousset.
2. Skeda ushtrimesh të përgatitur.
3. Fjalor i greqishtes së vjetër.